

ENGJËLLUSHE KARAJ

**RRETH PASURISË FRAZEOLOGJIKE
NË FJALORIN E GJUHËS SHQIPE TË A. XHUVANIT**

Një anë e patrajtuar gjerësisht në punimet rreth veprës së Aleksandër Xhuvanit, është edhe pasuria frazeologjike. Ne kemi disa vjet që merremi me fjalorin e hartuar prej tij dhe kjo pasuri shfaq vlera të shumta që mund të paraqiten nga këndvështrime të ndryshme.

Së pari pasuria e tij frazeologjike sjell elemente shumë të spikatura të kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit tonë, sepse është mbledhur drejtpërdrejt nga goja e tij. Prof. J. Thomai thekson se “Në praktikën leksikografike prof. A. Xhuvani dha kontributin e tij në dy drejtime kryesore: në mbledhjen e materialit leksikor e frazeologjik kryesisht drejtpërdrejt nga goja e popullit dhe në përpunimin e fjalorëve. Si nxënës e vijues i K. Kristoforidhit ai iu kushtua me pasion qëmtimit të fjalëve e të shprehjeve të bukura, tek të cilat shihte lëndë të çmueshme për pasurimin dhe zhvillimin e gjuhës. Në shumë punime gjuhësore të tij ngulmon vazhdimisht te fjala e frazeologjia popullore, kërkon, zbulon, shënon e studion çdo njësi me vlerë të gjuhës së popullit. Shembull i një pune këmbëngulëse e me dashuri janë edhe materialet leksikore e frazeologjike, që ai i mbledhi gjatë shumë vjetëve kryesisht nga goja e popullit dhe që kanë nisur të botohen në trajtë fjalori qysh nga viti 1971 në revistën "Studime filologjike" të përpunuara e të redaktuara nga prof. M. Domi e Q. Haxhihasani.”

Kurse prof. M. Domi shkruan për këtë: “Prof. A. Xhuvanit e tërhoqën gjithnjë shprehjet frazeologjike, frazeologjizmat e gjuhës sonë, si pasuri e saj dhe si shfaqje e veçorive të saj. Në mbledhjen e fjalëve, vëmendje të veçantë u kushtoi ai përdorimit të tyre, e sidomos togjeve të qëndrueshme. Materiali leksikor i mbledhur prej tij është i pasur me shprehje e frazeologjizma. Prof. Aleksandër Xhuvani është ndër vëzhguesit më të vëmendshëm të frazeologjisë shqipe e ndër studiuesit e parë të saj. Në materialet e ruajtura prej familjes së tij, vumë re edhe një shkrim të vogël me titullin “Frazeologji”, që na u duk i pabotuar në këtë formë, dhe e

përgatitëm për botim. Pati mirësinë të na e japë djali i prof. Aleksandër Xhuvanit, Genc Xhuvani.”¹

Së dyti, pasuria frazeologjike e mbledhur prej tij ka zënë vend në veprën që po përgatitim për botim, por që së pari ka njohur botimin në numra të ndryshëm të revistës Studime filologjike². Në fjalorin e pasqyruar në këto numra, frazeologjia është përzgjedhur nga profesorët Mahir Domi dhe Qemal Haxhihasani dhe është dhënë pranë fjalëve qendrore nga të cilat motivohen përgjithësisht njësitë përkatëse (rubrika *Fjalë e shprehje të gjuhës shqipe* në revistën Studimet filologjike është më se domethënëse, por ato janë pasqyruar në këtë revistë edhe si një grup paradigmatic i mëvetësishëm. Kështu në Studime filologjike 1983/1, jepet materiali *Frazeologji*, f. 193-195).

Për zbuluar vlerat, ne jemi ndalur në disa struktura të njohura, gjithnjë të vetëdijshëm për të mos bërë klasifikime të hollësishme dhe plota, sepse nuk mund të përfshihet gjithë pasuria që profesori ka sjellë, në një kumtesë të këtij lloji.

Në kuadrin e kësaj paraqitjeje, për të lehtësuar perceptimin ne kemi dhënë një klasifikim të shkurtër sipas kriterit strukturor tashmë të njohur³.

1. Njësi me strukturë togfjalëshi:

A. Njësi frazeologjike me strukturë njëgjymtyrëshe. Siç thotë prof. J. Thomai, “Këto struktura nuk janë të shumta në gjuhën shqipe dhe nënkuptojnë një gjymtyrë fakultative (ose kontekstore) paraprijëse, e cila mund të merret si gjymtyrë e njësisë frazeologjike”; p.sh. *më rri me vetull*⁴ etj.

B. Njësi frazeologjike dygjymtyrëshe (përbën grupin më të madh)

a. *Emër + emër*. Gjymtyrët e njësisë frazeologjike mund të jenë të bashkërenditura a të nënrenditura, *buzë më hundë* (keq).

b. *Emër + mbiemër*, ku gjymtyra emërore mund të prihet edhe nga një lidhës krahasuese: *jemi bukë e vjetër, me zemër të ngrime* etj.

¹ Aleksandër Xhuvani: *Frazeologji*, në “Studime filologjike”, 1983/1, f. 193-195 (përgatitur për botim nga M. Domi).

² Po listojmë këtu numrat e revistave ku është botuar ky fjalor: 1971/ 1; 1972/1, 2, 3, 4; 1973/3, 4; 1974/ 1, 2, 3; 1975/1, 2, 3, 4; 1976/ 1, 2, 3; 1977/2, 3, 4; 1978/1, 3, 4; 1979/1, 2; 1980/1, 4; 1981/ 1, 2, 4; 1982/ 1, 3, 4; 1983/1, 2, 3, 4; 1984/1; 1985/3; 1986/1, 2; 1987/1, 2, 3, 4; 1988/1, 2, 3; 1989/1, 2, 3; 1990/ 1, 2.

³ J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1981.

⁴ Të gjithë shembujt janë marrë nga *Fjalori i gjuhës shqipe* i Aleksandër Xhuvanit, të cilin po e përgatitim për ta botuar.

c. *Folje + emër: Ia blej mendjen, Na shet brofka (Him.), mos na shit gorrica, E bāj baltë, shuej pishën: bëj dëm të madh etj.*

ç. *Folje + ndajfolje: pret hollë, më vjen mbari etj.*

d. *Folje + numëror: i bëj katërsh etj.*

dh. *Folje + onomatope: s'bante njeri cing, mos ban cik me gojë etj.*

e. *Ndajfolje + ndajfolje: (flet) mbarë e prapë, (e shtyj) me sot me nesër: vrâ më vrâ etj.*

C. Njësi frazeologjike trigjymtyrëshe: *Bërtas në kupë të qiellës, më pikoi gjak shpirti etj.*

D. Njësi frazeologjike që kanë më shumë se tri gjymtyrë: *E bāj një punë me zemër nëpër kambë (Elb.), Me e mbajtë si edhin në dërrasë (Shk.) një gjā a një njeri, me e mbajtë në shuplakë, me e mbajtë në pëllambë të dorës etj.*

2. Njësi frazeologjike me strukturë fjalie: *i qante zemra, i vë një gur zemrës, më shkoi zemra në fund të barkut, na shkoi shpirti në fund të barkut etj.*

Së treti, një nga vlerat më të spikatura të pasurisë frazeologjike të mbledhur nga prof. A. Xhuvani është ajo se profesori, jo vetëm ka ditur të gjurmojë njësinë frazeologjike, por ai ka bërë një punë të vlerësueshme dhe shkencore edhe për shpjegimin kuptimor të tyre, duke dhënë si shpjegim një a më shumë njësi frazeologjike të tjera sinonime ose duke i shpjeguar me perifrazime ose me ndërthurjen e mënyrave të shpjegimit.

- Shpjegim me njësi të tjera frazeologjike:

Ia dha britmës (Elb.), vuri brimë (Himarë), ia krisi brimës, dha të britunit, ia dha bërtajën (Tir.)

S'ka si e buzë të dalë (Him.): s'ka sy e faqe të dal (prej turpit) (Elb.).

Bāj buzën më gas, shpie buzën më gas, vë buzën më gas, bie buzën më gas

Bie shi me knatë a me knaçë a me gup të knatës, bie shi me shtambë, a në grykë të shtambës, bie shi me rreshkë a me rrshiq (Shkod.), bie shi gjerbë qiejsh (Elb.).

më shkoi zemra në fund të barkut, na shkoi shpirti në fund të barkut (prej mallëngjimit a prej frikës);

- Me perifrazim

i vë një gur zemrës: përpqem të mos kujtoj një gjë të dhimbshme; bëj një punë për të mirë të dikujt, me gjithë të keqen që më ka bërë, me gjithë

qëndrimin që ka ndaj meje, bëj diçka me një farë shtrëngese nga vehtja, në një farë mënyre kundra vullnetit tim;

Me gjithë bark e ke?: me gjithë mend e ke?

E báj baltë një punë, një njeri: nuk e çmoj fare, e përbuz (Dibër).

Nuk më ban bef syu (Elbas.): nuk trembem fare.

Ia blej mendjen: e vëzhgoj tërthorazi dhe ia kuptoj mendimin.

Më bie në brijë një punë; i ra në brijë tashti kjo punë (Elb.): e kuptoi më në fund mbas kaqë mundimesh e provash.

S'kam futë sot erë brumi në bark (Elb.): s'kam ngrënë gjë fare sot.

I báj buzë bukës, gjellës, etj. (Elb.): nuk e dua, nuk më pëlqen.

Bie hundë më buzë, kanë ranë hundë më buzë (Elb.): janë hidhëruar tepër jo për ndonjë vdekje, por për një gjë të papëlqyeshme.

- Shpjegim i përzier

Ap me të madhe: përpiqem shumë: *dhash me të madhe që ta báj një punë, po nuk e mbarova dot.*

E fus në bigë ndokend: e shtrëngo, e vë në dilemë; *rashë në bigë:* u gjinda shumë ngushtë, s'dita nga t'ia jap.

Na shet brofka (Him.): na shet profka, dokra, sh. edhe: *mos na shit gorrica:* mos na thuaj gënjeshtër.

Bërtas në kupë të qiellës (Shkod.), *bërtas të fort' të qiellës* (Elb.): bërtas tepër.

Bie buzë më hundë; ra buzë më hundë (Elb.): u rrëzua e u vra keq; edhe: *ra më hundëzaj.*

Ma vû acár (që të nisem e të bëj një punë): më nguti me të madhe; edhe: *ma vû pishë* (Krue, Durrës).

E báj një punë me zemër nëpër kambë (Elb.) *a me zemër në gjû:* pa dëshirë, pa qejf prej idhnimit a hallit.

Së katërti, interesant është fakti se duke kundruar Fjalorin e gjuhës shqipe të Aleksandër Xhuvanit, vërejmë që shprehjet frazeologjike shumë shpesh autori i ka shpjeguar duke i përshtatur në gjuhë të huaja si: frëngjisht, italisht, gjermanisht, rumanisht, greqisht etj., p.sh.:

...shkoi me bisht ndër shalë: iku i turpëruar, **it.** partire umiliato da un luogo, andar via umiliato e confuso, scappare, mettersi la coda tra le gambe; **gjerm.** mit eingezogenen Schwanze; fig. kleinlaut geworden, beschämt; **fr.** perdre son aplomb; **rum.** cu coadă între picioare;...

...vërej, shikoj me bisht të syrit: **rum.** din coada ochiului, **gjerm.** verstehen nach jemandem blicken, nach ihm zchielen, **fr.** jeter des regards furtifs sur quelqu'un, lorgner quelque chose;...

Përshtatjet janë dhënë në mënyra të ndryshme. Autori i referohet Dozonit (në përshtatjet në frëngjisht – rreth 113 herë), Leottit (në përshtatjet në italisht – rreth 48 herë). Më poshtë po përmendim disa prej tyre:

- *Me shprehje frazeologjike:*
i dal ndanë a mb'anë një pune: fr. *venir à bout*
ia dreth arrëzën: fr. *je donne le coup de puce;*
bashkë ndf.: bahem bashkë: bëhem njësh, fr. *aller d'accord.*
bâj buzë në bukë, në të ngrënë, fr. *bouder à la table*
shkulem gazit, fr. *rire à gorge déployée;*
sa te ora: m'at ças, it. *in un battere d'occhio,* fr. *en un clin d'oeil*
marr anën (e ndokujt): bëhem me të, mbështes mendimin, qëndrimin e tij, fr. *prendre parti* (pour quelqu'un)

- *Me një fjalë të vetme:*
e la më nj'anë: s'u kujdes më, fr. *abandonner;*
mos e bân mizën buell: mos e tepro, fr. *n'exasgère pas.*
e kam punën angësht; kam ranë angësht: kam ranë ngushtë, fr. *je suis embarrassé;*
kam gojë të: fr. *prétendre;*

- *në mënyrë të përzier:*
neve të gjithëve na lëshoi zemra tue e ndie kët lajm të keq, it. *scoraggiarsi, demoralizzarsi, perdersi d'animo,* fr. *se laisser abattre;*
tanë buri e priti mikun: me buzë varë, it. *fare il broncio; qenka ngritë sot me buri,* gr. *μπουριά,* it. *arrabiatura, scoppio d'ira,* fr. *se fâcher, être courroucé, encoléré, irrité.*
qis, bëj arrakat, fr. *faire dégénérer,* abâtardir; dal, bëhem arrakat, se dégénérer (S. Kolea).
3. *bahem baltë, i bahem baltë* (dikuj): i përulem shumë, poshtërohem; fr. *s'humilier,* sh. edhe it. *essere servile;*

e ka ate me sy të mirë: është mirëdashës ndaj tij, ka mendim të mirë për të, gr. τοῦ έχω ὑπό εὐνοίαν, gjerm. jemandem wohlgesinnt werden, ihn wohlwollend ansehen, jemandem gut sein; fr. *avoir égard, être bienveillant envers quelqu'un, avoir de bonnes intentions à l'égard de quelqu'un*;

- *me perifrazim*:

vë në bukë: i jep punë, fr. lui conférer des emplois, lui procurer un emploi

s'e ha dot me mua: fr. tu n'es pas capable de me tenir tête;

i kthej shpinën ndokujt: fr. abandonner quelqu'un;

ka zanë kryet e vendit: fr. il a occupé une situation dominante;

i ka pre kryet t'jatis: i ngjan t'et: gjerm. er ist seinem Vater äie aus den Augen geschnitten; fr. c'est le portrait vivant de son père;

më rri vehtja si çudi, fr. c'est un étrange impression que je sens;

Së pesti, Fjalori i Xhuvanit është një fjalor i fjalës së rrallë, fjalor dialektor i mbarë shqipes. Fjalët e leksikut të përditshëm janë dhënë nga autori jo për të shpjeguar kuptimin e tyre, por për të dhënë në të shumtën e rasteve shprehjet frazeologjike, kuptimet e figurshme. Për ta ilustruar këtë po japim më poshtë frazeologji me fjalën *zemër*. Janë gjithsej 109 njësi frazeologjike me fjalën *zemër*. Numri i madh i njërive të mbledhura, shpjegimi i tyre në mënyrë të saktë etj. kanë bërë që rreth 100 njësi të kenë zënë vend në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, 1980.

zemër e *thyer, e mallëngjyer, e thekur, e bardhë, e zezë, e nxirë, e âmbël*: e butë; *më ngrini zemra*: më ngriu gjaku, u tremba shumë; **zemra** i *pikonte gjak* (prej idhnisë): ishte i pikëlluar shumë; *më pikoi në zemër*; *më kullon zemra gjak*; *m'u ngul gozhdë në zemër*; *i ka tha zemrën vdekja e djalit*; *ia thyej zemrën*: e dëshpëroj; *me zemër të thyer*; *fjalë, bisedë qi ther zemrën*; *i shtrydhi zemrën vdekja e të shoqes* (Doz. Man. 65); *i qante zemra*; *m'u shquar zemra* (arbër); *m'iku zemra, kur po e ndigjojshe atë tue qamë*; (Elb.); *më bëhet zemra zi e zgjyrë*; *më dridhet zemra kur mejtoj se...*; *kur e pashë ashtu, m'u bâ zemra hurdhë, shpellë*; *më kërcente zemra si pulë*; *i hypi zemra në fyt*; *më dridhton, më drithtoi zemrën*; *prekem shumë*; *më vete, më ka vojtë zemra në fund të këmbëvet, më shkoi zemra në fund të këmbëvet* (Elb.); *më shkoi zemra në fund të barkut* (Shkod); *më*

shkoi zemra në bark: m'u ka mbushë barku me frikë; *më ka ra zemra për tokë*; *i therte zemra*; *jam, rri me zemër të ngrimë* (për ndonjë frikë se ndodh gjëkafshë e rrezikshme, e papritur a duke pritur një gjë që nuk e dëshiroj); *ma bani zemrën gropë*; *shtrëngo zemrën* (për ndonjë vdekje); *më mbushet zemra*: më merr vaji, më hipën të qarit; *e bāna zemrën gur* (për ndonjë zi a të keqe): duroj; m'u *ba zemra* ujë; m'u *ba zemra* zi e zgjyrë; *më lufton zemra, më gufon zemra*; (prej ndonjë gëzimi), *më vlon zemra*; *më ka prekë në zemër, më ka thekë zemrën, më theri në zemër*; m'u *pre zemra* nga dëshpërimi; *më qan zemra se m'i vodhi të hollat ai*: kam dyshim; *mezi nga mëngjezi m'ardhi zemra*: mezi erdha në vete, e mora veten nga një ngjarje e tmerrshme që më pat rënë a që kam parë; (më, të) *lëshon zemra*: ligshohem, ligshohe, ligshohet, dëshpërohem, hidhërohem; it. *scoraggiarsi, demoralizarsi, perdersi d'animo*, fr. *se laisser abattre*; *i hypi zemra në fyt*; *me zemër në gju*; *me zemrën nëpër kambë*; m'u *zvertit zemra* (prej ndonjë pamjeje) gr. ἀδιαζώ (Korçë); *s'kam zemër të ndëgjoj, ta shof a ta baj një punë*; *s'më mbeti zemër*; m'u *pre zemra nga dëshpërimi*; *më thyhet zemra*: më prishet qejfi, jam i pakënaqur prej fjalëve jo të mira, prej sjelljes jo të mirë, *nuk na ep zemra me bâ ashtu*; *ia ul zemrën*: e bëj që t'i vijë keq për diçka, ose i zbres inatin; *nuk i ulet zemra*: nuk i vjen keq ose nuk i ikën zemërimi; *e u t'i siell zemrënë ndë vend* (Buz. Zekiel XXXIV 16): it. *ristorare, recar conforto, sollievo*; m'erdhi *zemra në vend*; *s'më bën zemra tani t'i ndih*; *nuk i bānte zemra t'iu thoshte*: nuk guxonte; *qi të mos i ban zemra me u afruom mb'atë ditë* (Budi, Pasq. 279): të mos guxoj; *ndë shkretëtirë bāni zemërë anēmiku me e temptuom* (ib. 161); *saa nde e vonë maa të mos bajsh zemërë me i fejyem* (ib. 182); *i ap zemër* (dikujt): it. *incoraggiare*; *marr zemër*, it. *incoraggiarsi*, gr. ἐνθαρρύνωμαι; *i bāj zemër ndonjenit*: i jap zemër, e inkurajoj; *gomari bëri zemër* (mori kurajë) *e i vej mbi malë lomarit* (arbër. e Greqisë); *i vë një gur zemrës*: përpiqem të mos kujtoj një gjë të dhimbshme; *bëj një punë për të mirë të dikujt, me gjithë të keqen që më ka bërë, me gjithë qëndrimin që ka ndaj meje, bëj diçka me një farë shtrëngese nga vehtja, në një farë mënyre kundra vullnetit tim*; *i vuna çelsin zemrës*; *do t'i shtie drynin zemrës*; *ma thotë zemra, ma do zemra: dua*; *si ndenji ca kohë në Amerikë i hoqi zemër*: e mori malli të kthehet në fshat; *më hyni në zemër*: nisa ta dua, gr. μου μπήκε στην καρδιά; *ma thotë zemra*, gr. τό λέγει ή καρδιά μου, *më qan zemra* (për diçka): dëshiroj me të madhe ta kem; *i laj zemrën*: dëshirën; *u bën zemrënë botës* (N. Fr. Ist. Përgj. 59): i kënaq; fr. *satisfaire*; *deshi t'i bëjë zemërënë gjindjesë* (Kristofor. Marku XV 15): το εκανόν πονήσαι: vá κάμη τό αρεστόν εις τόν άλλον, it. *volendo*

contentare il popolo, lat. *volens populo satisfacere*; *vetëm për atë i digjet zemra*: it. *mi bramava il cuore*; *më hyni në zemër ai njeri*, gr. *μού μπήκε στην καρδιά*; *më duel nga zemra*: s'e dua më; *e qiti nga zemra*, *e kam në zemër*: e dua; m'u ngrof *zemra*, m'u ftof *zemra*; m'u ba *zemra mal*: u gëzova shumë; *më ka plasë zemra me të pa ty*, *më ka plasë zemra me ta ndie zânin*: jam dëshiruar të të shoh, të ndiej zërin, kam dashur të të shoh e s'të kam parë; *kot je mundue për atë*, s'i ka le në *zemër atij* (me ta ba kete të mirë): nuk e ka në natyrë të vet (Shkod.); *më leu në zemër ta bëj këtë punë*: desha vetë, më erdhi dëshira (gjithnjë për diçka të mirë); *më ka le në zemër me të dhanë një dhuratë a një gjasend* (Elb.); *i hap zemrën* (dikujt): i hapem, fr. *se confesser*; *avoir confinace*; *ma ndiell zemra*: fr. *pressentir*, *presager*; *ta çel zemrën* (pija, heja), *ta vesh zemrën* (heja, pija); *ma ndien zemra*; *flas me zemër në dorë*: flas pa zhibla, sinqerisht; fr. *franchement*; *iku dhe e la atë me zemër nëpër kambë*: të hidhëruar, të brengosur; *me zemër varë*; *e dua me zemër*: vërtet, e dua sinqerisht; *s'më fle zemra tek ai*: s'kam besim; *ve dorën në zemër*: kam mëshirë, kam ndërgjegje; *duhet të vesh dorën në zemër*; *zemra e frytë të pëlçet sytë*: nga zemërimi nuk arsyeton kush drejt, nuk gjykon drejt; *më ngihet zemra*, *më velet zemra*; *ia shndosh zemrën dikujt*: e kënaq, fr. *satisfaite* (Kan. i L. Dukagjin. 61 e 62); *i ngjitet zemra* (në ndonjë); *e mbë ndonji kafshë qi di se të ngjit zemëra* (të pëlqen) (Budi, Pasq. 188); *më bënet zemra* (gëzohem shumë) *kur shoh që po mbijnë ato që mbolla*; *nuk më bie zemra rrafsh pa e mbarue atë punë* (Veri): nuk rri, nuk jam i qetë pa e kryer; *ha zemra tek unë*: ka dyshim tek unë; *diç i hëngri zemra* (kur ndigjoi së largu diçka): diç dyshoi; *e hangsh me zemër të mirë* (diçka), *i djegsh drutë me zemër të mirë*: i hangsh, i djegsh me gëzim, pa ndonjë të keqe a hidhërim.

Si përfundim, edhe nga ky vështrim i shkurtër për frazeologjinë në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të Aleksandër Xhuvanit konkludojmë se ai jo vetëm është njohës i rrallë i gjuhës shqipe dhe i të folmeve popullore, por ai ka ditur të qëmtojë me kujdes njësi frazeologjike që kanë vlera të shumta shprehëse, por edhe shënuese, ka ditur t'i dokumentojë dhe të lehtësojë punën për hartimin e botimin e fjalorit pas vdekjes, si dhe të bëhet një shembull për punën dialektologjike, leksikologjike, semantike dhe leksikografike për të gjithë ne të rinjtë të cilëve puna po na lidh me fjalën shqipe.